

V E N D I M
Nr. 654, datë 18.12.2002

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PËRDORIM TË PËRKOHSHËM NGA ORGANET SHTETËRORE, NË SITUATA EMERGJENTE, TË ÇDO MJETI PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 pika 2, 31, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile" dhe të nenit 37 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat, si më poshtë vijon:

a) Strukturat operative të emergjencave civile, në situata emergjente, kanë të drejtë të marrin në përdorim të përkohshëm çdo mjet privat, kundrejt pagesës, sipas tarifave të përcaktuara në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Për mjetet e tjera, që nuk janë përmendur në këtë shtojcë, llogaritjet të bëhen sipas fuqisë dhe tonazhit të tyre.

Llogaria bëhet duke shumëzuar vlerën në tabelë me koeficientin $k=1,2$ kur fuqia/tonazhi është më e/i madh dhe e kundërta. Për mjetet e transportit e materialeve të përdoret tabela për ton/km, kurse për mjetet stacionare fuqia në kw.

c) Kur strukturat operative të emergjencave civile, për mjetet që marrin në dispozicion, përballojnë karburantin nga rezervat e veta, atëherë tarifa llogaritet në bazë të orëve të punës për manovratorin, plus konsumin e pjesëve të ndërrimit (në rast komsumi), plus 10 për qind, si më poshtë vijon:

$T=(m+0,2m)+10\%$; ku T – tarifa; m – pagesa për një orë pune për manovratorin. Koeficienti $m=120$ deri 160 lekë, në varësi të tonazhit/fuqisë së mjetit. Kufiri minimal për tonazhin/fuqinë më të ulët dhe e kundërta.

ç) Kur merren mjete në dispozicion për transportin e udhëtarëve, si: autobusë, mikrobusë, etj. tarifat janë të njëjta me ato të udhëzimit të përbashkët nr. 373/1, datë 24.3. 1998 të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe nr. 99/3, datë 24.3.1998 të Ministrisë së Financave.

2. Mjetet merren në përdorim të përkohshëm, sipas aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet drejtuesve të operacionit ose përfaqësuesve të autorizuar prej tyre, për përballimin e situatave emergjente, për aq kohë sa është e domosdoshme, por jo më vonë sesa koha e përfundimit të emergjencës.

3. Shpenzimet që rezultojnë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve private, në raste të situatave emergjente, të përballohen nga burimet financiare të institucionit, të siguruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SHTOJCA
TARIFAT PËR MJETET TRANSPORTUESE VETËLËVIZËSE

Tabela 1

Nr.	Largësia e transportit	Km	Ton/km	Në lekë
1	Transporti deri në	0,2	-:-	40
2	Transporti deri në	0,5	-:-	30
3	Transporti deri në	1	-:-	25
4	Transporti deri në	2	-:-	22

5	Transporti deri në	3	-:-	20
6	Transporti deri në	4	-:-	18
7	Transporti deri në	5	-:-	17
8	Transporti deri në	6	-:-	16
9	Transporti deri në	7	-:-	15
10	Transporti deri në	8	-:-	14,5
11	Transporti deri në	9	-:-	14
12	Transporti deri në	10	-:-	12,8
13	Transporti mbi	10	-:-	12
14	Autoambulancë	1,5	-:-	20
15	Sheverlet	1,5	-:-	15

TARIFAT PËR MJETET NGRITËSE

Tabela 2

Nr.	Emërtimi i mjetit ngritës	Aftësia ngritëse në ton	Lek/orë
1	Autovinç	1,5	890
2	Autovinç	5	1500
3	Autovinç	8	1750
4	Autovinç	10	1900
5	Autovinç	16	2100
6	Autovinç	20	3000
7	Autovinç	mbi 20	3500

MJETE GËRMIMI

Tabela 3

Nr.	Emërtimi i mjetit	Njësia matëse	Kapaciteti	1 orë/pune	Në lekë
1	Fadromë "UNK 320"	-		-:-	4500
2	Buldozer DT – 54	-		-:-	1408
3	Buldozer DT – 75	-		-:-	1502
4	Buldozer S 80 – 100	-		-:-	2203
5	Buldozer S – 150	-		-:-	2890
6	Buldozer S – 350 HP	-		-:-	3426
7	Eksavator	m3	0,15	-:-	1220
8	Eksavator	m3	0,25	-:-	1391
9	Eksavator	m3	0,35	-:-	1409
10	Eksavator Varinski	m3	0,4	-:-	1511
11	Eksavator Varinski	m3	0,5	-:-	2225
12	Eksavator Varinski	m3	1-1,25	-:-	2673
13	Eksavator Varinski	m3	2	-:-	3567
14	Fadromë Volvo	-		-:-	3607
15	Motopompa "Gaz 51"	L/min		-:-	1500
16	Motokompresor	m3/sek		-:-	2000
17	Motogjenerator	kw	40	-:-	2000
18	Motogjenerator	kw	68	-:-	2500
19	Zjarrfikëse	ton	9	-:-	3500